



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE KUALIFIKIMEVE

RAPORTI PËRMBLEDHËS I AKREDITIMIT

**PËR SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE “THOMA PAPAPANO”,
GJIROKASTËR**

QERSHOR 2026

I. BAZA LIGJORE

Procesi i Akreditimit për ofruesit e arsimit dhe formimit profesional, mbështetet në Ligjin Nr. 15-2017 datë 16.02.2017 *“Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë”* i ndryshuar, në Urdhrin nr. 845, datë 3.7.2025 për miratimin e *“Rregullores për Standardet, kriteret dhe procedurat e akreditimit të ofruesve të arsimit dhe formimit Profesional”* të Ministrisë Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI), në rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe në urdhrin e brendshëm të AKAFPK-së me nr. 33, datë 23.07.2025 *“Për miratimin e udhëzuesit për procedurat e përzgjedhjes, organizimit dhe etikës profesionale të specialistëve si vlerësues të jashtëm në zbatim të procesit të akreditimit në institucionet ofruese të AFP-së”*.

II. KONTEKSTI I OFRUESIT

Histori e shkollës:

Më Tetor të vitit 1969 filloi ndërtimi i godinës së teknikumit 4-vjeçar të ndërtimit së bashku me konviktin në shërbim të saj. Mësimet gjatë kësaj periudhe zhvilloheshin pranë ndërmarrjes shtetërore të ndërtimit, Gjirokastër. Në shtator 1970 u çel shkolla industriale, në godinën ku është sot gjimnazi “Siri Shaplo”. Degët e mësimit që ofronte shkolla ishin ndërtim, mekanikë dhe kimikë. Mësimin e filluan së pari 300 nxënës, që ndiqnin studimet ditën (me shkëputje nga puna) dhe natën (pa shkëputje nga puna). Brenda 5 vitesh numri i nxënësve arriti 500 dhe më vonë u çel dhe dega elektrike. Në vitin 1986 shkolla u zhvendos në zonën industriale, në godinën ku kishte shërbyer si Teknikum i Ndërtimit dhe më pas si ndërmarrje artistike.

Pas viteve 90’ u kalua nga sistemi 4-vjeçar në atë 3-vjeçar profesional, e më pas trazirat e vitit 1997 e ulën ndjeshëm numrin e nxënësve në shkollën industriale, ku numri i vajzave ra në zero. Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano”, ka ofertën e saj arsimore në strukturën 2+1+1 në drejtimet mësimore: “Shërbime mjetesh transporti”, “Elektroteknikë”, “Termohidraulikë”, “Teknologji informacioni dhe komunikimi” dhe “Hoteleri-turizëm”, me informacione bashkëkohore, kabinete dhe laboratorë funksionalë, në shërbim të njohurive teorike dhe praktike. Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano”, Gjirokastër, ofron aktualisht këto kualifikime profesionale sipas KSHK-së:

1. “Shërbime mjetesh transporti” Niveli II në KSHK; M-II-25
2. “Shërbime elektro-auto” Niveli III në KSHK; M3-III-22
3. “Shërbime mjetesh transporti” Niveli IV në KSHK; M-IV-23
4. “Elektroteknikë” Niveli II në KSHK; Kodi E-II-21
5. “Instalime elektrike, civile dhe industriale” Niveli III në KSHK; E1-III-21
6. “Elektroteknikë” Niveli IV në KSHK; E-IV-25
7. “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” Niveli II në KSHK; T-II-25
8. “Mbështetje e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit” Niveli IV në KSHK; T2-IV-21
9. “Termohidraulikë” Niveli II në KSHK; V-II-20

10. “Instalime të sistemeve ngrohëse-ftohëse”, Niveli III në KSHK; V2-III-21
11. “Termohidraulikë” Niveli IV në KSHK; V-IV-23
12. “Hoteleri-Turizëm” Niveli II në KSHK; G-II-22
13. “Shërbime në hotel dhe restorant” Niveli III në KSHK; G5-III-24
14. “Hoteleri-Turizëm” Niveli IV në KSHK; G-IV-25

III. PËRMBLEDHJA E PROCESIT

Ofruesi Publik i AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano”, Gjirokastrë, depozitoi kërkesën për akreditim pranë AKAFPK-së me nr. 165 prot. datë 31.07.2025 “Kërkesë për Akreditim”, protokolluar pranë institucionit tonë me nr. 277 prot., më datë 04.08.2025. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve, në zbatim të Urdhrit nr. 845/2025 të MEKI nisi procesin e Akreditimit duke ngritur dhe konsoliduar grupin e vlerësuesve të jashtëm (GVJ), përmes një procedure të miratuar më parë.

GVJ, për hartimin e Raportit të Vlerësimit të Jashtëm të akreditimit të Shkollës së Mesme Profesionale “Thoma Papapano”, Gjirokastrë me qëllim sigurimin e një analize të plotë dhe të saktë ka përdorur metoda dhe instrumente të ndryshme, si më poshtë:

A. Metoda

1. Analizimi paraprak i dokumentave të dorëzuar në AKAFPK;
2. Mbledhja e të dhënave përmes;
 - Kryerjes së vizitave në mjediset e shkollës me këto veprimtari:
 - o Vëzhgimi i orëve mësimore;
 - o Vëzhgimi i ambienteve (shkollës; biznes);
 - o Shqyrtimi i dokumentacionit;
 - o Kryerja e intervistave/takimeve/fokus-grup me drejtues, staf administrativ/mbështetës, palë interesi (nxënës, biznes, mësues).
 - Përdorimit të pyetësorëve me grupet e interesit (mësimdhënës, nxënës, prindër, komuniteti i biznesit);
3. Shkrimi i raportit në Google Drive duke bërë:
 - o Analizën e të dhënave dhe krahasimin e gjetjeve me kriteret për të përcaktuar përputhjen;
 - o Nxjerrjen e konkluzioneve dhe rekomandimeve përkatëse;
4. Dorëzimi i raportit paraprak nga GVJ në AKAFPK (i firmosur) së bashku me evidencat mbështetëse;
5. Marrja e komenteve nga AKAFPK dhe rishikimi i raportit paraprak nga GVJ;
6. Hartimi dhe dorëzimi i raportit me reflektimet dhe sugjerimet përkatëse.

B. Instrumentet e përdorura

- Formular i analizimit të të dhënave dhe dokumenteve
- Lista kontrolli për vëzhgimin e orëve mësimore

- Lista kontrolli për vëzhgimin e ambjenteve
- Formular për intervista.

Organizimi i punës.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, i përbërë nga tre anëtarë, organizoi punën me ndarje të qartë të detyrave për grumbullimin, analizën dhe përpunimin e dokumentacionit. Diskutimet për gjetjet dhe rekomandimet u zhvilluan në mënyrë bashkëpunuese duke siguruar vendimmarrje të përbashkët. Koordinimi u realizua duke kombinuar bisedat fizike me komunikimin online, dhe përmes kontaktit të vazhdueshëm me koordinatorin e procesit pranë AKAFPK për çdo çështje që kërkonte sqarim. Ky organizim siguroi një proces efikas dhe një analizë të plotë të rezultateve.

Mbyllja

Në fund të procesit të akreditimit, Raporti përfundimtar përmbante gjetjet kryesore dhe rekomandimet që ofruesi Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano”, Gjirokastrë do të duhet të ndjekë më tej.

IV. GJETJET PËR 5 FUSHAT E CILËSISË

Fusha 1 Menaxhimi.

Janë dokumentuar të gjitha proceset dhe rezultatet e pritshme, puna në grup, përfshirja dhe konsultimi me të gjithë grupet e interesit (përfaqësues të punëdhënësve, të mësimdhënësve, të nxënësve, prindërve) si në menaxhim dhe vendimmarrje. Shkolla e mesme profesionale “Thoma Papapano”, Gjirokastrë, planifikon dhe përdor në mënyrë të integruar të gjitha llojet e burimeve (njerëzore, financiare, materiale), duke përdorur ciklin e cilësisë dhe në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe me nevojat e identifikuara të institucionit. Ambientet janë të dizenuara për të ofruar një mjedis të sigurt, të përshtatshëm dhe të rehatshëm për mësimdhënie dhe nxënie. Të gjithë nxënësit dhe stafi kanë akses në tualete të pajisura sipas standardeve të higjienës në fuqi. Individët me nevoja të veçanta (me aftësi të ndryshe/të kufizuara) marrin mbështetje të përshtatshme për të arritur rezultatet e pritshme dhe kanë akses tek ambientet sipas projektimit universal.

Fusha 2 Marrëdhënia dhe bashkëpunimi.

Drejtorja e shkollës, shpërndan sistematikisht informacion qeverisjes dhe institucioneve vendore mbi veprimtarinë dhe rezultatet e shkollës. Drejtorja dhe stafi kryejnë raportimet e kërkuara me ligj pranë institucioneve qendrore dhe vendore. Drejtorja dhe personeli përgjegjës i ofruesit të AFP-së komunikojnë sistematikisht me grupet e interesit, komunitetin i informojnë rregullisht ato mbi veprimtarinë dhe rezultatet e shkollës si dhe për kualifikimet profesionale, certifikatat profesionale dhe diplomat që ofrohen, për të rritur nivelin e regjistrimit dhe të frekuencimit, si dhe për të ulur nivelin e mungesave dhe braktisjes.

Fusha 3 Kurrikula e zbatuar.

Kurrikula shkollore hartohet duke u bazuar në standardet e profesioneve dhe standardet e kualifikimeve profesionale në fuqi përmes një procedurë të qartë. Planifikimi i burimeve garanton zhvillimin e kompetencave kyçe dhe kompetencave profesionale në kushte reale dhe thuajse reale pune. Tekstet shkollore dhe pajisjet ofrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me kërkesat e standardeve. Kurrikula respekton parimet e mosdiskriminimit dhe shanset e barabarta për të gjithë nxënësit, pavarësisht nga gjinia, etnia, kultura, besimi fetar apo ndonjë formë tjetër. Planet dhe aktivitetet përfshijnë masa për të siguruar që të gjithë nxënësit, përfshirë ata me nevoja të veçanta, të kenë akses të barabartë në arsim dhe mundësi për zhvillim.

Fusha 4 Mësimdhënia dhe të nxënit.

Ka përshtatshmëri të përdorimit të materialeve dhe burimeve të mësimdhënies dhe nxënies. Procesi i mësimdhënies dhe nxënies garanton zhvillimin e kompetencave kyçe. Individët me nevoja të veçanta (me aftësi të ndryshe/të kufizuara) marrin mbështetje të përshtatshme për të arritur rezultatet e pritshme dhe kanë akses tek ambientet sipas projektimit universal. Ambientet janë të dizenuara për të ofruar një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm për mësimdhënie dhe nxënie. Të gjithë nxënësit dhe stafi kanë akses në tualete të pajisura sipas standardeve të higjienës në fuqi.

Fusha 5 Vlerësimi.

Mësuesit përdorin metodologjitë dhe instrumentet e planifikuara për vlerësimin e vazhduar. Metodologjitë dhe instrumentet e përdorur mbulojnë rezultatet e të nxënit dhe kompetencat e përcaktuara nga standardet, dhe përdoren në procesin mësimor. Të dhënat dhe evidencat mbi rezultatet e vlerësimit të nxënësve, progresin dhe performancën e tyre mbledhen dhe regjistrohen rregullisht. Planifikimi dhe organizimi i provimeve të niveleve realizohet sipas legjislacionit në fuqi. Përfaqësuesit e biznesit janë shumë të pranishëm dhe ndihmojnë shumë në organizimin e praktikave profesionale. Drejtorja e shkollës merr masa për sigurimin e mjediseve, infrastrukturës dhe burimeve njerëzore dhe materiale për organizimin e provimeve.

V. REKOMANDIMET E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR

FUSHA 1 MENAXHIMI

Rekomandim nr. 1 (Kriter bazë 1.2.1.1 *)

GVJ rekomandon që shkolla të angazhohet në mënyrë më aktive për publikimin në kohë të planeve dhe raporteve institucionale në faqen zyrtare të institucionit, me qëllim rritjen e transparencës institucionale dhe informimin e palëve të interesuara (nxënës, prindër, komunitet, partnerë etj.), brenda 6 muajve e në vijim.

Rekomandim nr. 2 (Kriter bazë 1.2.1.2 *)

GVJ rekomandon që në planin e ardhshëm afatmesëm, rezultatet e konsultimit me grupet e interesit për të gjitha kualifikimet profesionale që shkolla ofron (edhe për ato kualifikime ku numri i

regjistrimeve është zero) duhet të jenë më të dukshme (p.sh. duke përfshirë përmbledhje të strukturuar dhe specifike të rekomandimeve të marra nga të gjitha palët e interesit - kryesisht biznes, nxënës, mësimdhënës dhe/ose evidenca të takimeve, konsultimeve të realizuara për të siguruar një pasqyrë të plotë dhe transparente të procesit të konsultimit).

Rekomandim nr. 3 (Kriter plotësues i papërmbushur 1.2.1.4)

GVJ rekomandon që gjatë rishikimit të planit afatmesëm, shkolla të përfshijë objektiva, masa dhe veprimtari konkrete që lidhen me arsimin gjithëpërfshirës, për pjesëmarrjen dhe mbështetjen e të gjithë nxënësve, pa dallim aftësish, gjinie apo sfondi social dhe ta aplikojë edhe për hartimin e planit afatmesëm të ardhshëm.

Rekomandim nr. 4 (Kriter bazë 1.2.1.5*)

GVJ rekomandon që në rishikimin e planit afatmesëm aktual dhe në hartimin e planit të ardhshëm afatmesëm listimi i kualifikimeve profesionale që ofrohen në Shkollën e Mesme Profesionale “Thoma Papano” Gjirokastër, të kryhet sipas emërtimeve në Katalogun Kombëtar të Kualifikimeve bashkë me kodet përkatëse.

Rekomandim nr. 5 (Kriter bazë 1.2.1.5*)

GVJ rekomandon që në rishikimin e planit afatmesëm aktual dhe në hartimin e planit të ardhshëm afatmesëm shkolla të ketë në vëmendje rishikimin dhe vendosjen e objektivave specifike për kualifikimet profesionale ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero.

Rekomandim nr. 6 (Kriter bazë 1.2.2.2 *)

GVJ rekomandon që në planin e ardhshëm vjetor 2026-2027 treguesit e performancës të hartohen në mënyrë të qartë dhe të matshme sipas natyrës së objektivit edhe për kualifikimet profesionale ku numri aktual i regjistrimeve është zero.

Rekomandim nr. 7 (Kriter bazë 1.2.2.3 *)

GVJ rekomandon që, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, shkolla të vendosë në planin vjetor objektiva SMART, të hartojë aktivitete dhe të përcaktojë tregues performance edhe për kualifikimet ku numri aktual i regjistrimeve është zero.

Rekomandim nr. 8 (Kriter bazë 1.4.2.2)

GVJ rekomandon që duke filluar nga viti shkollor 2025-2026 shkolla, të përfshijë në planin e përmirësimit të cilësisë edhe analizën e treguesve kryesore që kanë të bëjnë me regjistrimet/diplomimet, sidomos për kualifikimet aktualisht me zero regjistrime, duke përcaktuar fushat dhe aktivitetet për përmirësim.

Rekomandim nr. 9 (Kriter bazë 1.4.2.4 *)

GVJ rekomandon që shkolla të angazhohet në mënyrë më aktive në shpërndarjen e informacionit për rezultatet e vetëvlerësimit të institucionit, përmes publikimit të raporteve dhe planeve vjetore në forma të ndryshme duke përfshirë edhe platformat dhe mediat vizive, online ose të shkruara, sipas përcaktimeve, duke bërë të paktën nga një publikim deri në fund të vitit shkollor 2025-2026.

Rekomandim nr. 10 (Kriter bazë 1.5.2.3 *)

GVJ rekomandon që drejtorja dhe koordinatori i ZHVP të kryejnë rishikimin dhe plotësimin e planeve individuale të zhvillimit profesional dhe të dokumentojnë bashkëpunimin mes tyre (p.sh. firmosja e planeve nga të dy), brenda 3 mujorit të parë të vitit shkollor të ardhshëm.

Rekomandim nr. 11 (Kriter bazë 1.6.2.3 *)

Në lidhje me menaxhimin e burimeve të tjera financimi të tilla si, të ardhurat e vetëgjeneruara, tarifat e shërbimit, kontributet nga donatorët, GVJ rekomandon monitorimin e aktivizimit të këtyre burimeve kur sigurohen fondet dhe dokumentimit të përdorimit të tyre në mënyrë transparente.

Rekomandim nr. 12 (Kriter bazë 1.6.3.1 *)

Në lidhje me cilësinë e mjedisit fizik, GVJ rekomandon që shkolla duhet të dokumentojë veprimtarinë e “Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit” sipas pikës 3) a,d,e dhe pikës 4 të nenit 159 të Udhëzimit nr. 759/2024 të MEKI, brenda 6 muajve, dhe në vijim.

Rekomandim nr. 13 (Kriter bazë 1.6.3.4 *)

GVJ rekomandon që drejtoria e ofruesit të AFP-së, brenda tremujorit të parë të vitit shkollor 2026-2027 të kryejë një analizë të përputhshmërisë ndërmjet numrit të regjistrimeve dhe strukturës së mjediseve mësimore për kualifikimet me numër aktual regjistrimesh zero me qëllim përshtatjen e numrit të regjistrimeve me mundësitë reale të shkollës.

Rekomandim nr. 14 (Kriter bazë 1.6.4.2 *)

GVJ rekomandon që shkolla duhet të mbështesë me të paktën një evidencë vlerësimin e kriterëve që kanë të bëjnë me çështjet e sigurisë, gjatë plotësimit të dokumentit “Për analizën e bizneseve potenciale për bashkëpunim” (dokumenti 9, në Manualin e Praktikave), për të gjitha bizneset me të cilat ka lidhur kontrata për praktikën e nxënësve, brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim nr. 15 (Kriter bazë 1.6.4.3 *)

GVJ rekomandon që drejtoria e shkollës të dokumentojë shpërndarjen të punonjësit ndihmës të materialeve për mirëmbajtje të mjediseve, sipas kërkesave dhe bazuar në raportet e monitorimit të “Komisionit të Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit”.

Rekomandim nr. 16 (Kriter bazë 1.6.5.2 *)

Komisioni i Sigurisë dhe Shëndetit të planifikojë dhe dokumentojë shpërndarjen të stafit dhe nxënësit e shkollës të “Rregullores për sigurinë në shkollë dhe mbrojtjen dhe shëndetin e të punësuarve në vendin e punës” (Lista emërore, procesverbale, foto) brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim nr. 17 (Kriter bazë 1.6.5.4 *)

GVJ rekomandon që shkolla duhet të dokumentojë veprimtarinë në lidhje me sigurinë sipas pikës 3 të nenit 161 të Udhëzimit nr. 759/2024 të MEKI, brenda 6 muajve (p.sh. foto, lista pjesëmarrjeje, komunikime zyrtare, relacione), gjatë vitit shkollor 2026-2027.

FUSHA 2 MARRËDHËNIA DHE BASHKËPUNIMI**Rekomandim nr. 18 (Kriter bazë 2.2.1.2 *)**

Shkolla/koordinatorët e NJZH të angazhohen për plotësimin e të gjitha rubrikave të dokumentit nr. 11 “Oferta e shkollës”, sipas Manualit të Praktikave, sipas afateve të përcaktuara në Manual brenda 6 muajve.

Rekomandim nr. 19 (Kriter plotësues 2.2.2.2)

GVJ rekomandon që shkolla/koordinatorët e NJZH të plotësojnë dosjen e praktikave profesionale me të gjitha dokumentet shoqëruese përkatëse (sipas Manualit të praktikave profesionale), për të

siguruar mbledhjen e të dhënave nga partnerët mbi aktivitetet e të nxënësve në vendin e punës dhe rezultatet e tyre gjatë vitit shkollor 2025-2026.”

Rekomandim nr. 20 (Kriter bazë 2.3.1.1 *)

GVJ rekomandon që shkolla të detajojë në planin afatmesëm aktual informacionin mbi grupet e interesit dhe partnerët nga shoqëria civile, fushat e bashkëpunimit dhe afatet e veprimtarive të përbashkëta brenda 6 muajve, si dhe të sigurojë përfshirjen e këtij informacioni në hartimin e planit afatmesëm të ardhshëm.

Rekomandim nr. 21 (Kriter bazë 2.4.1.1 (*))

GVJ rekomandon që shkolla të detajojë gjatë rishikimit të planit afatmesëm aktual informacionin mbi të gjithë partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, donatorët dhe grupet e interesit, fushat e bashkëpunimit dhe afatet e veprimtarive të përbashkëta brenda 6 muajve, si dhe të sigurojë përfshirjen e këtij informacioni në hartimin e planit afatmesëm të ardhshëm.

Rekomandim nr. 22 (Kriter bazë 2.4.2.1 *)

GVJ rekomandon që shkolla të detajojë, gjatë rishikimit të planit afatmesëm aktual informacionin mbi të gjithë institucionet arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare, veçanërisht institucionet arsimore, nga të cilat ofruesi i AFP-së regjistron/tërheq nxënës/kursantë, si dhe ato institucione, ku të diplomuarit e AFP-së mund të vijnë arsimimin e tyre, fushat e bashkëpunimit dhe afatet e veprimtarive të përbashkëta brenda 6 muajve, si dhe të sigurojë përfshirjen e këtij informacioni në hartimin e planit afatmesëm të ardhshëm.

FUSHA 3 KURRIKULA E ZBATUAR

Rekomandim nr. 23 (Kriter bazë 3.1.1.1 *)

Shkolla/koordinatorët e NJZH të angazhohen për plotësimin e të gjitha rubrikave të ofertës mësimore të shkollës për biznesin, sipas të dokumentit nr. 11 të Manualit të Praktikave, brenda tremujorit të parë 2026-2027.

Rekomandim nr. 24 (Kriter bazë 3.1.1.2 *)

GVJ rekomandon që për vitin shkollor të ardhshëm 2026-2027 shkolla të përcaktojë në mënyrë të qartë të gjithë hapat e procedurës për hartimin e planeve mësimore, bashkë me rolet dhe përgjegjësitë, si dhe me afatet e zbatimit.

Rekomandim nr. 25 (Kriter bazë 3.1.3.1 *)

Rubrika “Burime/Materiale për realizim” në planet e ardhshme vjetore dhe ditare të plotësohet në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me standardin përkatës të kualifikimit profesional dhe skeletkurrikulën, duke specifikuar të gjitha pajisjet, materialet dhe mjetet konkrete të nevojshme për zhvillimin e orës mësimore dhe të praktikës profesionale, për të gjitha kualifikimet profesionale, duke filluar nga viti i ardhshëm shkollor.

Rekomandim nr. 26 (Kriter bazë 3.1.3.1 *)

GVJ rekomandon që për kualifikimet ku aktualisht nuk ka nxënës të regjistruar, drejtoria brenda muajit të parë pas fillimit të procesit mësimor në këto kualifikime, të sigurojë zbatimin e planeve mësimore dhe përdorimin efektiv të burimeve duke dokumentuar procesin (fletë vlerësimi i orës mësimore, raport monitorimi, etj).

Rekomandim nr. 27 (Kriter plotësues 3.1.4.2 *)

GVJ rekomandon që për kualifikimet ku aktualisht nuk ka nxënës të regjistruar, drejtoria brenda muajit të parë pas fillimit të procesit mësimor në këto kualifikime, të sigurojë zbatimin e kurrikulës dhe zhvillimin qartazi të kompetencave kyçe, me një theks të veçantë tek aftësitë e shkrimit dhe leximit, aftësitë numerike, aftësitë komunikuese dhe aftësitë digjitale duke dokumentuar procesin (fletë vlerësimi i orës mësimore, raport monitorimi, etj).

Rekomandim nr. 28 (Kriter bazë 3.1.5.1 *)

GVJ rekomandon brenda vitit shkollor 2026-2027 që të gjithë mësimdhënësit/instruktorët e praktikës profesionale të shkollës së mesme profesionale “Thoma Papapano” të krijojnë një dokumentim të plotë dhe të strukturuar të praktikës profesionale dhe vlerësimeve në përputhje me Urdhrin nr. 1407, datë 18.06.2025 “Manuali i Menaxhimit Institucional të Praktikave Profesionale” për të gjitha kualifikimet profesionale të ofruara nga institucioni, duke përfshirë edhe kualifikimet që aktualisht kanë regjistrime zero, menjëherë sapo ato të aktivizohen.

Rekomandim nr. 29 (Kriter bazë 3.1.5.2 *)

GVJ rekomandon që duke filluar nga viti i ardhshëm shkollor mësimdhënësit e praktikës profesionale në bashkëpunim me instruktorin në biznes të hartojnë programin e praktikës profesionale sipas modeleve të rekomanduara në Udhëzimin e AKAFPK dhe Urdhrin nr. 1407, datë 18.06.2025 “Manuali i Menaxhimit Institucional të Praktikave Profesionale”, për të gjitha kualifikimet profesionale të ofruara nga institucioni, duke përfshirë edhe kualifikimet që aktualisht kanë regjistrime zero, menjëherë sapo ato të aktivizohen.

Rekomandim nr. 30 (Kriter bazë 3.2.1.1 *)

GVJ rekomandon që mësimdhënësit e teorisë profesionale të përgatisin/përshtasin materiale mësimore mbështetëse për lëndët, për të cilat mungojnë tekstet shkollore të botuara, (duke u mbështetur edhe te materialet mbështetëse që gjenden në faqen www.akafpk.gov.al) dhe t'i shpërndajnë ato te nxënësit në fillim të vitit shkollor 2026-2027.

FUSHA 4 MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNIT**Rekomandim nr. 31 (Kriter bazë 4.1.1.1 *)**

GVJ rekomandon që për kualifikimet ku aktualisht nuk ka nxënës të regjistruar, drejtoria brenda muajit të parë pas fillimit të procesit mësimor në këto kualifikime, të sigurojë hartimin e planeve ditore për të gjitha lëndët/modulet të kurrikulave respektive duke dokumentuar procesin (fletë vlerësimi i orës mësimore, raport monitorimi, etj).

Rekomandim nr. 32 (Kriter bazë 4.1.2.1 *)

GVJ rekomandon që shkolla të plotësojë dokumentimin e praktikës profesionale dhe vlerësimeve sipas Dokumentit 6 të Manualit të praktikave në biznes, brenda vitit shkollor 20025-2026, për kualifikimet profesionale aktive.

Rekomandim nr. 33 (Kriter bazë 4.1.2.1 *)

GVJ rekomandon që në lidhje me kualifikimet ku numri aktual i regjistrimeve është zero duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, shkolla të plotësojë dokumentimin e praktikës profesionale

dhe vlerësimeve sipas Dokumentit 6 të Manualit të praktikave në biznes, sapo këto kualifikime të aktivizohen.

Rekomandim nr. 34 (Kriter bazë 4.1.2.2 *)

GVJ rekomandon që për kualifikimet ku aktualisht nuk ka nxënës të regjistruar, drejtoria/njësia përgjegjëse të sigurojë përdorimin efektiv dhe të dokumentuar të të gjitha burimeve (infrastrukturës, mjediseve dhe mjeteve mësimore), qoftë në pronësi të saj apo të partnerëve, sipas vëllimeve dhe strukturës së përcaktuar në kurrikulat përkatëse nga të gjithë mësimdhënësit.

Rekomandim nr. 35 (Kriter plotësues 4.1.2.3)

GVJ rekomandon që për kualifikimet ku aktualisht nuk ka nxënës të regjistruar, drejtoria të sigurojë që të gjithë mësimdhënësit të përdorin rezultate të nxëni për çdo njësi praktika profesionale gjatë hartimit të planeve zhvillohet në kohë dhe me burimet e nevojshme sapo të regjistrohen nxënësit, duke garantuar zhvillimin e aftësive praktike për të gjithë nxënësit e regjistruar dhe duke dokumentuar të gjithë procesin.

Rekomandim nr. 36 (Kriter bazë 4.2.1.1 *)

GVJ rekomandon që mësimdhënësit të përdorin rezultatet e të nxënit për çdo njësi (të shprehura në njohuri, aftësi dhe kompetenca më të gjera) për çdo standard kualifikimi, për hartimin e kurrikulës, programit të trajnimit ose përgatitjes së portofolit të aftësive për të gjitha llojet e kualifikimeve profesionale.

Rekomandim nr. 37 (Kriter plotësues 4.3.1.1)

GVJ rekomandon që, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, të gjithë mësimdhënësit të planifikojnë dhe organizojnë aktivite ndërkurrikulare për kualifikimet profesionale me regjistrime aktuale zero, sapo të aktivizohen.

Rekomandim nr. 38 (Kriter plotësues i papërmbyshur 4.3.1.2)

GVJ rekomandon që brenda vitit të ardhshëm shkollor 2026-2027 të gjithë mësimdhënësit të integrojnë përdorimin e teknologjive mësimore në lëndët e tyre, për mbështetjen e mësimi interaktiv dhe diversifikimin e metodave të punës dhe vlerësimit për të gjitha kualifikimet profesionale.

Rekomandim nr. 39 (Kriter plotësues i papërmbyshur 4.3.1.3)

GVJ rekomandon që duke filluar nga viti shkollor 2026-2027 mësimdhënësit të përdorin instrumente, metoda, teknika dhe platforma mësimore për të nxitur aktivizimin e nxënësve për kualifikimet profesionale me numër aktual regjistrimesh zero, sapo të aktivizohen.

Rekomandim nr. 40 (Kriter plotësues 4.3.1.4)

GVJ rekomandon që duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, mësimdhënësit të përdorin instrumente dhe metoda mësimore për të përmbyshur objektivat mësimore në fushën e të nxënit social dhe emocional.

Rekomandim nr. 41 (Kriter bazë 4.3.2.1)

GVJ rekomandon, që duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, gjatë orës së mësimi të përdoren edhe materiale digjitale, pajisje TIK, aplikacione, pajisje apo materiale të tjera ndihmëse, sipas planifikimit për të gjitha kualifikimet aktive, duke përfshirë ato me regjistrime aktuale zero sapo të aktivizohen.

Rekomandim nr. 42 (Kriter plotësues i papërmbushur 4.3.2.2)

GVJ rekomandon që mësime të mësimdhënësve të hartojnë, përshtatin ose ndajnë materiale mësimore sipas kërkesave kurrikulare, duke përfshirë ato digjitale brenda gjatë vitit shkollor 2026-2027 e në vijim.

Rekomandim nr. 43 (Kriter plotësues i papërmbushur 4.4.1.1)

GVJ rekomandon që brenda 6 muajve shkolla të dokumentojë të paktën një rishikim/ndryshim të planeve, materialeve, strategjive mësimore duke evidentuar qartë lidhjen me rezultatet e vlerësimit dhe të anketave.

Rekomandim nr. 44 (Kriter plotësues i papërmbushur 4.4.1.2)

GVJ rekomandon që për vitin shkollor 2026-2027 mësime të mësimdhënësve të praktikës të planifikojnë në planet vjetore të moduleve të praktikës profesionale orë për praktikimin e nxënësve të prapambetur në fund të çdo moduli, (në përputhje me Udhëzimin e AKAFPK në fillim të vitit shkollor).

Rekomandim nr. 45 (Kriter bazë 4.5.1.4 *)

GVJ rekomandon që drejtoria e shkollës, pavarësisht qëndrimit refuzues të prindit, të ndjekë në vazhdim për vitet shkollore të ardhshme, procedurën institucionale me qëllim përcaktimin e nevojave arsimore dhe të nevojës për mësues ndihmës, duke dokumentuar çdo hap të procesit, në përputhje me kuadrin ligjor “Udhëzimi nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar” (ndryshuar me udhëzimin nr. 21, datë 22.8.2025), Kreu I, pika 6.

Rekomandim nr. 46 (Kriter bazë. 4.5.2.1 *)

GVJ rekomandon që për vitin e ardhshëm shkollor, koordinatori i karrierës të rishikojë aktivitetet e planit të orientimit në karrierë dhe të planifikojë veprimtari të përshtatshme për orientimin në karrierë për nxënësit me aftësi ndryshe.

FUSHA 5 VLERËSIMI**Rekomandim nr. 47 (Kriter bazë 5.1.1.2)**

GVJ rekomandon në lidhje me kualifikimet ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero që duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, çdo mësime të mësimdhënës të mbajë një plan individual për monitorim dhe vlerësim, sapo këto kualifikime të aktivizohen.

Rekomandim nr. 48 (Kriter bazë 5.1.1.4)

GVJ rekomandon në lidhje me kualifikimet ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero që duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, çdo mësime të mësimdhënës të dokumentojnë aktivitetet dhe rezultatet e vlerësimit të vazhduar duke përdorur edhe vlerësimin individual dhe të njeri- tjetrit, sapo këto kualifikime të aktivizohen.

Rekomandim nr. 49 (Kriter plotësues 5.1.1.5)

GVJ rekomandon në lidhje me kualifikimet profesionale ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero që, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, të gjithë mësime të mësimdhënës të dokumentojnë përdorimin e metodave dhe instrumenteve për vlerësimin e vazhduar (përmbledhës) në fund të çdo njësie mësimore, sapo këto kualifikime të aktivizohen.

Rekomandim nr. 50 (Kriter bazë 5.1.1.6)

GVJ rekomandon në lidhje me kualifikimet ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero që, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, të gjithë mësimdhënësit të dokumentojnë përdorimin e veprimtarive dhe rezultateve të vlerësimit të vazhduar (përmbledhës), në përputhje me legjislacionin në fuqi, sapo këto kualifikime të aktivizohen.

Rekomandim nr. 51 (Kriter plotësues i papërmbushur 5.1.1.7)

GVJ rekomandon që ekipet lëndore/departamentet të dokumentojnë (p.sh procesverbale të takimeve/mbledhejeve të departamenteve template instrumenti vlerësimi, etj) bashkëpunimi mes mësuesve në planifikimin e koordinuar të instrumenteve për vlerësimin përfundimtar)

Rekomandim nr. 52 (Kriter plotësues 5.1.3.1)

GVJ rekomandon në lidhje me kualifikimet ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero që, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, të gjithë mësimdhënësit të dokumentojnë informimin e nxënësit, prindërit/ kujdestarin ligjor për kriteret, metodat, instrumentet dhe afatet kohore për vlerësimin e vazhduar dhe përfundimtar, sapo këto kualifikime të aktivizohen.

Rekomandim nr. 53 (Kriter plotësues 5.1.3.2)

GVJ rekomandon në lidhje me kualifikimet ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero që, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, të gjithë mësimdhënësit të dokumentojnë informimin e nxënësit, prindërit/ kujdestarin ligjor për rezultatet e vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar, sapo këto kualifikime të aktivizohen.

Rekomandim nr. 54 (Kriter plotësues i papërmbushur 5.1.4.1)

GVJ rekomandon që shkolla të dokumentojë konsultimin me bizneset për hartimin e metodologjive dhe të instrumenteve të vlerësimit, kryesisht për vlerësimin e rezultateve të nxënësit me bazë punën. p.sh., listë prezencë të takimit, procesverbale/minutave të takimeve, foto, publikime etj, brenda vitit shkollor 2026-2027.

Rekomandim nr. 55 (Kriter plotësues 5.1.4.2)

GVJ rekomandon në lidhje me kualifikimet ku numri aktual i regjistrimeve është zero, që brenda vitit shkollor 2026-2027 drejtoria e shkollës të sigurojë dhe dokumentojë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të sektorëve përkatës të biznesit në provimet/komisionet e vlerësimit sipas kuadrit ligjor, për këto kualifikime sapo të aktivizohen.

Rekomandim nr. 56 (Kriter plotësues 5.1.4.3)

GVJ rekomandon që për kualifikimet profesionale ku numri i regjistrimeve është zero, drejtoria të informojë përfaqësuesit e bizneseve respektive për mungesën e regjistrimeve brenda tremujorit të parë të vitit shkollor dhe të dokumentojë informimin (procesverbal mbledhje/takimi, etj).

Rekomandim nr. 57 (Kriter plotësues 5.1.4.3)

GVJ rekomandon që për kualifikimet profesionale ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, drejtoria të informojë përfaqësuesit e bizneseve respektive për rezultatet përfundimtare, kur këto kualifikime të aktivizohen dhe nxënësit të jenë vlerësuar.

Rekomandim nr. 58 (Kriter plotësues 5.1.4.4)

GVJ rekomandon që për kualifikimet profesionale ku aktualisht numri i regjistrimeve është zero, duke filluar nga viti shkollor 2026-2027, drejtoria të vlerësojë se sa të kënaqur janë përfaqësuesit

e bizneseve respektive me rezultatet dhe rëndësinë e vlerësimit të nxënësve, kur këto kualifikime të jenë të aktivizuara.

VI. VENDIMI PËR AKREDITIM

Në bazë të raportit të akreditimit dhe propozimit të AKAFPK-së, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit mori vendimin për **akreditim** për ofruesin publik të AFP-së, Shkolla e Mesme Profesionale “Thoma Papapano”, Gjirokastrë me Vendim nr. 239, datë 02.06.2026.

AKAFPK ka lëshuar certifikatën e akreditimit, me nr. serie 22, data 19.06.2026, me afat vlefshmërie deri më 01.06.2030.